**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAVAJË**

**Nr. _____ prot.** **Datë ____/____/____**

# PROJEKT – VENDIM

**DATË _____ / _____ / 2026**

**Për**

**Vendosjen e emrit SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA të Sheshit në Njesinë Administrative Luz i Vogël, me këtë motiviacion:**

**"Për kontributin e madh dhënë për komunitetin e Njësisë Administrative Luzi i Vogël, si atdhetar, nacionalist e patriot i shquar i kësaj treve".**

Në mbështetje të nenit 54, germa "m", dhe Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", në Ligjin 8480, date 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Ligjin Nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit ne Republikën e Shqiperisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqiperisë", në Kodin e Procedurave Administrative, në mbledhjen e radhës, Kryetari i Bashkisë Kavajë i kërkon Këshillit të Bashkisë Kavajë:

**VENDOSI:**

1. **Vendosjen e emrit SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA të Sheshit në Njesinë Administrative Luz i Vogël**

2. Drejtoria e Shërbimeve në bashkëpunim me Njesinë Administrative Luz i Vogël për të ndihmuar në vendosjen e bustit me emrin e këtij atdhetari.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve

**DREJTORIA E KULTURËS DHE SPORTEVE**

**GENTIAN JAUPI**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIAN MALAJ**

**NËNKRYETAR I BASHKISË**

**GENCI GJYLSHENI**

**DREJTORIA LIGJORE**

**HELIDON PLAKU**

**SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**MERI BITURKU**

**KRYETARI I BASHKISË**

**FISNIK QOSJA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAVAJË**

**Nr. _____ prot.** **Datë _____/____/____**

**PROCES – VERBAL**

**Për Vendosjen e emrit SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA të Sheshit në Njesinë Administrative Luz i Vogël**

I mbajtur sot me datë ___ / ____ / 2026, nga Komisioni ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me Nr.933 prot. Datë ___ /___/ 2026,

**Për Vendosjen e emrit SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA të sheshit në Njesinë Administrative Luzi i Vogël**

Me motivacionin:

**"Për kontributin e madh dhënë për komunitetin e Njësisë Administrative Luzi i Vogël, si atdhetar, nacionalist e patriot i shquar i kësaj treve"**

**K O M I S I O N I**

| | | |
|---|---|---|
| Genci | Gjylsheni | (Kryetar) |
| Gentian | Jaupi | (Anetar) |
| Stefanaq | Sotja | (Anetar) |
| Dhurata | Hoxha | (Anëtare) |
| Fatmira | Rrena | (Anetar) |

# RELACION

**Me propozim te Kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Fisnik Qosja, mbështetur në kërkesën e bërë nga z.Agim Rubjega, perfaqësues i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, dega Kavajë, me kerkesën e bërë nga një grup qytetarësh, familjarësh dhe të afërmish si dhe banorë të Njesisë Administrative Luzi i Vogël, Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve, i propozon Këshillit Bashkiak Kavajë,**

**Vendosjen e emrit SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA, sheshit kryesor në Njesinë Administrative Luz i Vogël**

**SEJDIN LUSHA,** i datëlindjes 05.05.1898, ka lindur në fshatin Luz i Vogël të Njësisë Administrative me të njëjtin emër. Rrjedh nga një familje e nderuar dhe patriotike e kësaj treve. Ai është rritur dhe edukuar me ndjenjat më të larta patriotike dhe nacionalisate. Gjatë jetës së tij dhe në veçanti gjatë luftës, është shquar për veprimtarinë e tij të vazhdueshme për të ruajtur traditat, frymën patriotike, nacionaliste dhe antikomuniste të Kavajës.

Me ardhjen e partisë komuniste në pushtet në vitin 1944, ka filluar kalvari i përndjekjes së tij dhe familjes Lusha. Në këto kushte u detyrua të arratisej jashtë atdheut. Gjatë kësaj periudhe komunistët kanë vazhduar në mënyrë të pandaluar fushatën e tyre të persekutimit ndaj të gjithë nacionalistëve dhe familjeve të tyre. Shumica e familjes "Lusha" u burgosën në burgjet famëzezë të regjimit dhe disa u internuan.

I prekur rëndë nga tragjedia që po kalonte familja e tij dhe shumica e familjeve patriotike dhe nacionaliaste shqiptare, **SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA**, iu përgjigj thirrjes së një grupi atdhetarësh për të emigruar në shtetin Gjerman dhe erdhi veti i katërt në Shqipëri, në korrik të vitit 1951, për një kryengritje të armatosur antikomuniste. Në këtë kohë kur po e prisnin të oiganizonin qendrësën kundër regjimit komunist, është zbuluar nga forcat e sigurimit famëkeq të shtetit dhe është rrethuar në zonën e Rrajcës së Librazhdit. Pas dy ditë dhe netë luftimesh dhe përpjekjesh me sigurimin e shtetit, ra heroikisht duke u ekzekutuar mizorisht me djegie të gjallë duke gjetur vdekjen.

Pas këtij akti makabër edhe pse u bë identifikimi i trupit të tij nga shefi i sigurimit të kohës, nuk u lejua që **SEJDIN LUSHA**, të varrosej e nderohej nga familjarët e tij dhe AI është pa varr deri sot. Fa,miljarët e të afërmit e tij, anëtarë të shoqëatës, vuajtën persekuptimin e egër komunist deri në ardhjen e demokracisë.

Në këto kushte për të rivendosur sado pak në vend nderin e kësaj familje dhe ne vecanti përkujtiumin e heroizmit të patriotit dhe nacionalistit të shquar **SEJDIN (Nuredin) MyslimLUSHA**, që të jetë si frymëzim për brezat e sotëm,

**i kërkojmë Këshillit Bashkiak Kavajë**

Emërimin e sheshit para Njesisë Adninistrative Luz i Vogël, me emrin e nacionalistit të shquar të kësaj treve, **SEJDIN (Nuredin) Myslim LUSHA** dhe vendosjen e një busti të tij në këtë shesh.

**DREJTORI**

**GENTIAN JAUPI**